

Procesverbal - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës/Nr Ref: Pastrim i Liqenit Bovillë me mjete teknologjike REF-59946-02-22-2023

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

98300000-6

Vlera e fondit limit : 31.852.369,33 (Tridhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje tridhjetë e tre) lekë pa t.v.sh.

Fondi limit është përlogaritur bazuar në testimin e tregut me anë të tre ofertave nga tre operatorë ekonomikë të ndryshëm.

Në bazë të pikës 1,b të nenit 76 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 26 dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare ,2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për

të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht : 15.926.184,6 (Pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër presje gjashtë) leke pa t.v.sh.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pika 2,b e nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$50\% \times 31.852.369,33 = 15.926.184,6 \text{ lekë pa t.v.sh}$$

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë 3(tre) viteve të fundit 2019, 2020, 2021. Për të vertetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit, në të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dalë me humbje të pakten në dy vite të njëpasnjëshëm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2 e LPP, si dhe pika 2,dh e nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Shërbime te ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 12.740.947,7 (Dymbëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë presje shtatë) leke pa t.v.sh të kryera gjatë tri viteve të fundit (përlllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përmbushjen e kriterit të sipërpërmendur Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$40\% \times 31.852.369,33 = 12.740.947,7 \text{ lekë}$$

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategorinë e mëposhtme:

NS-15 Pastrim i ujrave detare, liqenore dhe lumore.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se

kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.

Argumentimi: Pikat e Licences vendosen bazuar në natyrën e shërbimit objekt Prokurimi.

NS-15 Pastrim i ujrave detare, liqenore dhe lumore, konsiderohet pastrimi me mjete teknike, speciale të veçantë të çfarëdolloji uji dhe të transportit të materialeve që dalin nga pastrimi i tij në vende të caktuara me akte normative.

Pikat e Liçencës janë kërkuar bazuar në natyrën e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 10 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik I klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **janar 2023**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **janar 2023**

Argumentimi: Numri i punonjësve është kërkuar 10 (dhjetë) pasi natyra e punës është e tillë , sipërfaqja e Bovillës është e madhe dhe angazhimi është më I madh.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën(**Janar 2023**)

- (një) Inxhinier Mjedisi

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 9 te DST.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ,të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse) .

Argumentimi: Bazuar në Ligjin Nr.162 datë 23.12.2020 neni 77 Kërkesat për kualifikim pika 1/c si dhe në përshkrimin e detyrave në Relacionin teknik për objektin e prokurimit.

Duke qenë se pastrimi do të shërbente jo vetëm cilësisë së ujit, funksionaliteti i veprës por dhe biodiversitetit , mbrojtjes mjedisore, faunës , gjallesave , natyrës kërkohet një inxhinier mjedisi për zbatimin me përpikmëri të detyrës së përshkruar në relacionin Teknik.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit duhet të ketë pjesë të stafit dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit të paktën:

- 1(një) drejtues Makineri korrëse/prerëse
- 1(një) pastrues mbetjesh

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 9 te DST.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezoje prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ,të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës me përshkrimin e punësimit përkatës si dhe listëpagesat përkatëse për periudhën(**Janar 2023**) për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST. Në rastin kur drejtuesi për makineri korrëse/prerëse janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur për tu siguruar se operatori ekonomik I cili do të marrë përsipër shërbimin ka në staf personelin e duhur për të kryer shërbimin object prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", *Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"*.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 9 te DST.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezoje prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ,të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomë/certifikatë për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Argumentimi: Bazuar në ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakinist dhe një eskavatorist.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes se Kontrates, të gjithë dokumentacionin provues për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per muajin e fundit kjo për rastin kur operatori ekonomik i disponon në pronësi mjetet dhe makineritë. Për

rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpërmjet kontratës së qerasë atëherë operatori ekonomik për punonjësit manovrator duhet të paraqesë **kontratë punësimi** për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nevojat drejtuesit e mjeteve për kryerjen e shërbimit me qëllim realizimin e objektit të prokurimit

2.3.8 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001- 2015** ose ekuivalente (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

b. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001-2015** ose ekuivalente. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt- marrëveshjes).

Argumentimi:

ISO 9001- 2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimin e produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 14001-2015 Çertifikimi I Sistemit për Menaxhimin Mjedisor

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

2.3.9 Kandidati ofertues duhet të disponojë minimalisht pajisjet dhe mjetet e mëposhtme, për kryerjen e shërbimit me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamionçinë	1 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri korrëse/prerëse për barërat e këqija, pastruese me sipërfaqe nga mbetje të ndryshme plastike sipas specifikimeve teknike.	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 Ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Jelek pune 10 (dhjetë) copë
- Jelek shpëtimi 10 (dhjetë) copë
- Rripa sigurimi 10 (dhjetë) copë
- Këpucë të sigurimit kundër rrëshkitjes 15 (dhjetë) copë
- Kaska mbrojtëse 10 (dhjetë) copë
- Doreza pune 10 (dhjetë) copë

- Kuti e ndihmës së shpejtë 5 (pesë) copë
- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makinëritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ,të gjithë dokumentacionin provues për makinëritë e mesipërme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.